



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit**

Vendos: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 13 mars 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Mocionin Përmbledhës të Prokurorisë për Pranimin e Provave të
W02677-ës sipas Rregullës 153 dhe Parashtrimet në Lidhje me W04436-ën dhe
W04395-ën**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtëses së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21, 37 dhe 40(2) dhe (6)(h) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 137-138, 141(1) dhe 153 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 27 shkurt 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") paraqiti një mocion për pranimin e provave të dëshmitarit W02677 sipas rregullës 153 dhe parashtrimet në lidhje me W04436-ën dhe W04395-ën ("Mocioni").¹
2. Ekipet e mbrojtjes të të katër të akuzuarve (së bashku, "Mbrojtja") nuk iu përgjigjën Mocionit.

II. PARASHTRIMET

3. ZPS-ja parashtron se: (i) Trupi Gjykues ka konstatuar ndërkohë që intervista e ZPS-së me W02677-ën² ("Deklarata e W02677-ës") është relevante, *prima facie* autentike, me vlerë provuese dhe e përshtatshme për t'u pranuar sipas rregullës 154;³ (ii) ZPS-ja është pajtuar me një propozim *inter partes* të Mbrojtjes për të pranuar deklaratën e W02677-ës sipas rregullës 153;⁴ dhe se (iii) deklarata e

¹ F02969, Prokurori i Specializuar, *Mocioni Përmbledhës i Prokurorisë për Pranimin e Provave të W02677-ës sipas rregullës 153 dhe Parashtrime të Lidhura me W04436-ën dhe W04395-ën*, 27 shkurt 2025, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u lëshua po atë ditë, F02969/RED).

² 076247-TR-ST Pjesa 1-ET RED dhe 076247-TR-ST Pjesa 2-ET RED (përfshirë përkthimet). *Shih gjithashtu*, Shtojca 1 e Mocionit.

³ Mocioni, para. 4, që i referohet F02245, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave të W01978-ës, W02540-ës, W02677-ës, W02714-ës, W02951-shit, W03865-ës, W03881-shit, W04371-shit, W04710-ës, dhe W04850-ës sipas rregullës 154 dhe Ndryshimin e Listës së Provave Materiale* ("Vendim sipas rregullës 154"), 16 prill 2024, konfidencial, para. 40-42, 44 (versioni i redaktuar publik u lëshua po atë ditë, F02245/RED).

⁴ Mocioni, para. 3.

W02677-ës i përmbush të gjitha kriteret relevante për pranueshmëri.⁵ ZPS-ja kërkon gjithashtu që intervista e W04436-ës e vitit 2010⁶ ("Deklarata e W04436-ës") të pranohet si provë sipas rregullës 153, duke qenë se ZPS-ja e respektoi urdhrin e Trupit Gjykses dhe nxori versionin e nënshkruar në shqip të Deklaratës së W04436-ës.⁷ Gjithashtu, ZPS-ja sqaron se nuk ka ndërmend të bëjë ndonjë kërkesë sipas rregullës 153 në lidhje me W04395-ën.⁸

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Trupi Gjykses përfshin përmes referimit dispozitat ligjore përkatëse, sikundër përcaktohet në Vendimin e tij të parë sipas rregullës 153, si edhe ligjin e zbatueshëm për pranimin e provave, në përgjithësi, sikurse përcaktohet në Vendimin e Parë për Provat Jogojore.⁹

IV. DISKUTIM

A. W02677

5. Trupi Gjykses vëren se: (i) më 16 prill 2024, e miratoi mocionin e ZPS-së për pranimin e provave të W02677-ës sipas rregullës 154;¹⁰ dhe se (ii) ZPS-ja aktualisht kërkon pranimin e Deklaratës së W02677-ës sipas rregullës 153 pas një propozimi

⁵ Mocioni, para. 3.

⁶ SITF00013316-00013335 RED.

⁷ Mocioni, para. 6-7, që i referohet F02937, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve* W00964, W02172, W02538, W02549, W04238, W04380, W04386, W04436, W04661, dhe W04734 sipas rregullës 153 ("Vendimi sipas Rregullës 153"), 14 shkurt 2025, konfidencial, para. 77 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F02937/RED).

⁸ Mocioni, para. 2.

⁹ F01904, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave sipas Rregullës 153*, 3 nëntor 2023, konfidencial, para. 8-10, 12-13 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 27 nëntor 2023, F01904/RED); F01380, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Pranimin e Provave të Dymbëdhjetë Dëshmitarëve të Parë sipas Rregullës 154*, 16 mars 2023, konfidencial, para. 11-25 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 7 nëntor 2023, F01380/RED); F01409, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Provave Jogojore të Prokurorit të Specializuar*, 31 mars 2023, konfidencial, para. 8-13.

¹⁰ Vendimi sipas Rregullës 154, para. 44, 96(a).

inter partes nga Mbrojtja për në lidhje me këtë. Në veçanti, ZPS-ja parashtrohet se Deklarata e W02677-ës është relevante, *prima facie* autentike, me vlerë provuese dhe e përshtatshme për pranim sipas rregullës 153 dhe se vlera provuese e saj nuk zhbëhet nga asnjë efekt dëmtues.¹¹ ZPS-ja parashtrohet gjithashtu se pranimi i saj sipas rregullës 153 do të shmangte çdo stres, shpenzim të panevojshëm apo çrregullime të tjera në jetën e dëshmitarit, duke përfshirë një traumat të serishme të mundshme.¹²

6. Siç u tha më lart në lidhje me kërkesën e ZPS-së për pranim sipas rregullës 154, Trupi Gjyqësor ka konstatuar ndërkohë se Deklarata e W02677-ës është *prima facie* relevante, autentike dhe ka vlerë provuese.¹³

7. Në lidhje me përshtatshmërinë e Deklaratës së W02677-ës për pranim sipas rregullës 153, Trupi Gjyqësor gjykon se: (i) mbrojtja nuk kundërshton pranimin e saj;¹⁴ dhe se (ii) ZPS-ja parashtrohet se Deklarata e W02677-ës në masë të madhe është përsëritëse dhe është konfirmuar nga dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë dhe ato dokumentare, duke përfshirë dëshmitarë me të cilët të akuzuarit patën mundësi të përballeshin.¹⁵

8. Trupi Gjyqësor është bindur se Deklarata e W02677-ës, që ka 33 faqe në anglishte: (i) është e shkurtër, se (ii) nuk ka përsëritje të panevojshme; dhe se (iii) ofron kryesisht prova për krime të cilat provojnë çështje të tjera nga veprimet dhe sjellja e të akuzuarve të përfshira në Aktakuzë. Trupi Gjyqësor kujton gjithashtu konstatimin e tij në lidhje me autenticitetin *prima facie* të Deklaratës së W02677-ës.¹⁶ Rrjedhimisht, Trupi Gjyqësor është i bindur se Deklarata e W02677-ës ka *prima facie* vlerë provuese, nuk shkakton dëm të papërligjur, dhe se kriteret për

¹¹ Mocioni, para. 4.

¹² Mocioni, para. 5.

¹³ Vendimi sipas rregullës 154, para. 40-42.

¹⁴ *Shih* Mocioni, para. 3, që i referohet pranimit nga ZPS-ja të propozimit *inter partes* të Mbrojtjes për pranimin e Deklaratës së W02677-ës sipas rregullës 153.

¹⁵ Mocioni, para. 4, dhe referencat e cituara në të.

¹⁶ Vendimi sipas Rregullës 154, para. 41.

një gjykim të drejtë e të shpejtë për ligjin në mënyrë të jashtëzakonshme pranimin e deklaratës pa marrje në pyetje nga pala jothirrëse.

9. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se Deklarata e W02677-ës është e pranueshme sipas rregullës 138(1) dhe 153, pa marrje në pyetje nga pala jothirrëse.

B. W04436

10. ZPS-ja kërkon që Deklarata e W04436-ës të pranohet si provë, sipas rregullës 153, duke qenë që ZPS-ja ka respektuar vendimin e Trupit Gjykses dhe e nxori versionin në shqipe të nënshkruar nga W04436.¹⁷

11. Trupi Gjykses vëren se, më 14 shkurt 2025, ai miratoi pjesërisht mocionin e ZPS-së për pranim e provave të W04436-ës sipas rregullës 153.¹⁸ Në veçanti, Trupi Gjykses konstatoi se provat e W04436-ës, duke përfshirë Deklaratën e W04436-ës, janë *prima facie* relevante, autentike dhe kanë vlerë provuese.¹⁹ Trupi Gjykses konstatoi gjithashtu se Deklarata e W04436-ës nuk shkakton dëm të papërligjur dhe se kriteret për një gjykim të drejtë dhe të shpejtë e për ligjin domosdoshmërisht pranimin e deklaratës pa marrje në pyetje nga pala jothirrëse.²⁰ Megjithatë, Trupi Gjykses konstatoi se Deklarata e W04436-ës nuk i plotësonte kriteret e rregullës 153(2), dhe e shtyu vendimin e tij për pranueshmërinë e Deklaratës së W04436-ës deri sa ZPS-ja të përmbushë kriteret e rregullës 153(2).²¹

12. Trupi Gjykses konstaton se më 26 shkurt 2025, ZPS-ja nxori versionin në shqip të deklaratës të W04436-ës të nënshkruar prej tij.²² Rrjedhimisht, Trupi

¹⁷ Mocioni, para. 6-7.

¹⁸ Vendimi sipas Rregullës 153, para. 78.

¹⁹ Vendimi sipas Rregullës 153, para. 73-74, 76, 78.

²⁰ Vendimi sipas Rregullës 153, para. 78.

²¹ Vendimi sipas Rregullës 153, para. 77.

²² SITF00372788-SITF00372797 RED, Paketa me materiale të nxjerra 1605. *Shih gjithashtu*, Mocioni, para. 7.

Gjykues është bindur se Deklarata e W04436-ës i përmbush kriteret e rregullës 153(2).

13. Për këto arsye, Trupi Gjykues konstaton se Deklarata e W04436-ës është e pranueshme sipas rregullës 138(1) dhe 153, pa marrje në pyetje nga pala jothirrëse.

V. VENDIM

14. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

- a) **MIRATON** Mocionin;
- b) **PRANON** si prova, pa marrje në pyetje nga pala jothirrëse, materialet e mëposhtme, duke përfshirë edhe përkthimet e tyre: (i) Deklaratën e W02677-ës;²³ dhe (ii) Deklaratën e W04436-ës;²⁴ dhe
- c) **URDHËRON** Administratoren të: (i) caktojë numra të provave materiale për materiet e përmendura në paragrafin 14(b); dhe të (ii) caktojë klasifikimin e përmendur në Shtojcën 1 të Mocionit dhe Shtojcën 8 të vendimit F02782 për materialet e pranuar.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E enjte, 13 mars 2025

Në Hagë, Holandë.

²³ *Shih më lart*, poshtëshënimi 2.

²⁴ *Shih më lart*, poshtëshënimet 6, 22.